



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori II 2019



Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	4
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	4
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	6
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	8
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	9

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesorë të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e dytë të vitit 2019 dhe krahasimet me tremujorin e parë të vitit 2019 dhe me tremujorin e dytë të vitit 2018, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP”-“Shërbimet Postare”

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e dytë të vitit 2019 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (15 subjekte):**
 1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S);
 2. Albanian Courier sh.p.k (A.C);
 3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx);
 4. DHL International (Albania) sh.p.k;
 5. RAD MAIL sh.p.k;
 6. Sky Net Logistic sh.p.k;
 7. TNT Express Albania sh.p.k;
 8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex);
 9. United Transport sh.p.k (Uni Trans);
 10. Youth Albania Professional Services (YAPS);
 11. Fast-Delivery sh.p.k;
 12. E-KOMPLET sh.p.k;
 13. COEX shpk;
 14. Albanian Parcel Distribution shpk.
 15. Speed Couriers Albania (Albi Shkurta – person fizik)

Posta Shqiptare me VKD Nr.2581, datë 22.06.2015 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 rezultojnë 6,976,058 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të detajuara si më poshtë:

Tabela 1.1- Të dhëna përmbledhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara në tremujorin e dytë 2019 dhe krahasimi me tremujorin e parë 2019 dhe me tremujorin e dytë 2018.


Shërbime postare të ofruara	T2_2018	T3_2018	T4_2018	T1_2019	T2_2019	Ndryshim T2_2019/ T1_2019	Ndryshim T2_2019/ T2_2018
Posta Shqiptare sh.a							
1 Shërbim Universal Postar							
1.1 Postë brenda vendit	5,057,453	4,596,180	4,246,184	4,821,716	5,524,563	14.6%	9%
1.2 Postë ndërkombëtare	326,467	486,011	234,923	413,819	440,588	6.5%	35%
1.3 Totali 1.1+1.2	5,383,920	5,082,191	4,481,107	5,235,535	5,965,151	13.9%	11%
2 Shërbim joniversal postar							
2.1 Postë brenda vendit	589,209	793,573	896,597	266,060	126,798	-52.3%	-78%
2.2 Postë ndërkombëtare	300	224	472	262	5,310	1926.7%	1670%
2.3 Totali 2.1+2.2	589,509	793,797	897,069	266,322	132,108	-50.4%	-78%
3 Shërbim ekspres							
3.1 Ekspres brenda vendit	170,829	187,313	177,621	175,231	172,580	-1.5%	1%
3.2 Ekspres ndërkombëtar	5,068	3,729	5,434	6,400	6,448	0.8%	27%
3.3 Totali 3.1+3.2	175,897	191,042	183,055	181,631	179,028	-1.4%	2%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare							
4 Shërbim JoUniversal Postar							
4.1 Postë brenda vendit	124,881	130,202	117,747	147,651	155,986	5.6%	24.9%
4.2 Postë ndërkombëtare	166,819	9,714	8,653	10,702	10,515	-1.7%	-93.7%
4.3 Totali 4.1+4.2	291,700	139,916	126,400	158,353	166,501	5.1%	-42.9%
5 Shërbim ekspres							
5.1 Ekspres brenda vendit	193,025	377,011	414,844	424,681	465,936	9.7%	141.4%
5.2 Ekspres ndërkombëtar	52,887	55,381	61,763	58,899	67,334	14.3%	27.3%
5.3 Totali 5.1+5.2	245,912	432,392	476,607	483,580	533,270	10.3%	116.9%
6 Totali 1.3+2.3+3.3+4.3+5.3	6,686,938	6,639,338	6,164,238	6,325,421	6,976,058	10.3%	4.3%

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare) T2 2019

	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P.Sh</i>	6,276,287	90%
<i>Of. e tjerë</i>	699,771	10%
Totali	6,976,058	100%

Për sa rezulton nga të dhënat e reflektuara në tabelën 1.2 sa më sipër, për tremujorin e dytë të vitit 2019 Posta Shqiptare zë rreth **90%** të tregut postar përkundrejt Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare të cilët së bashku zënë **10%**.

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujorë




Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, Posta Shqiptare në tremujorin e dytë 2019 ka realizuar 6,276,287 shërbime postare, shifër e cila përkthehet në 592,799 objekte postare më shumë se tremujori i parë 2019, sikundër ofruesit e shërbimeve postare në tremujorin e dytë 2019 kanë realizuar 57,838 objekte postare më shumë se në tremujorin e parë të vitit 2019.

Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T2-2019

Sh.U	Sh. jo univers.	Sh.ekspres	Totali
5,965,151	298,609	712,298	6,976,058
85.5%	4.3%	10.2%	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me rreth 85.5% ose 5,965,151 objekte postare, ndjekur nga shërbimi ekspres me 10.2% ose 712,298 objekte postare. Shërbimi jo universal zë 4.3% ose 298,609 objekte postare.

Grafiku 1.2 Ecuria në 3-mujorë sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet qartë që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar, i cili luhetet në nivelet rreth 86% për tremujorin e dytë të vitit 2019. Nga krahasimi i periudhës T2-2019 me periudhën T1-2019, vërehet një rritje e numrit të shërbimeve postare në masën 650,637 shërbime, sikundër nga krahasimi i tremujorit të dytë të vitit 2019 me tremujorin e dytë të vitit 2018 vërehet një rritje e shërbimeve postare në masën rreth 289,120 shërbime.


2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T2-2019

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	5,524,563
Postë ndërkombëtare	440,588
Totali	5,965,151

Nga të dhënat e tabelës 1.4 vihet re se gjatë tremujorit të dytë 2019, për sa i përket shërbimit Universal Postar, Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,965,151 objekte, nga të cilat Postë brenda vendit 5,524,563 ose 93%, dhe Postë ndërkombëtare 440,588 objekte, ose 7%. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,627,551 shërbime për objekte të thjeshta dhe 897,012 shërbime për Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 74,683 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 365,905 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 mujë



3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare


Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:

Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Shqiptare

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
Shërbim universal postar	5,965,151	95%
Shërbim jo universal postar	132,108	2%
Shërbim ekspres	179,028	3%

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 5,965,151 objekte postare ose 95%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 179,028 objekte postare ose 3%, dhe shërbimi jo universal me 132,108 objekte postare ose 2%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujorë



Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare gjatë 3-mujorëve të vitit 2019 dhe 3-mujorëve të vitit 2018, nga ku vihet re një rënie e ndjeshme në numrin e objekteve postare për shërbimin jo universal dhe një rritje e ndjeshme për shërbimin universal e krahasuar kjo me tremujorin e parë të vitit 2019.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Sh	132,108	44%
Of. e tjerë	166,501	56%
Totali	298,609	100%

Nga të dhënat e raportuara rezulton se për sa i përket shërbimit jo universal postar, treguesit më të mirë i kanë Ofruesit e tjerë me 166,501 objekte postare ose 56% të tregut, kundrejt Postës Shqiptare me 132,108 objekte postare ose 44%.

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujorë



Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në tremujorin e dytë 2019 krahasuar me tremujorin e parë 2019 janë ulur për Postën Shqiptare me 134,214 objekte, ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare janë rritur me 8,148 objekte. Nga krahasimi mbi bazën e periudhave tremujore, konstatohet rënie e pjesëve të tregut të Postës Shqiptare për këtë shërbim, ku nga rreth 67% që zinte në tremujorin e dytë të vitit 2018, pjesa e tregut të Postës Shqiptare për këtë tregues ka arritur në rreth 44%.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 përbëhej nga 282,784 objekte brenda vendit dhe 15,825 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.


5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë

Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të dytë të vitit 2019, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2018, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare) për tremujorin e dytë 2019.

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesa tregut
P.Shqiptare	179,028	25%
Of. e tjerë	533,270	75%
Totali T2-2019	712,298	100%

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria ne 3-mujore



Siç vihet re, për sa i përket shërbimit ekspres, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 ka pasur rritje të shërbimeve postare ekspres e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit 2018, sikundër vërehet rritje në shërbimet postare ekspres për tremujorin e dytë të vitit 2019 e krahasuar kjo me tremujorin paraardhës (T1–2019). Gjithashtu, për shërbimin ekspres vërehet një rënie e pjesëve të tregut për Postën Shqiptare, ku nga rreth 42% të tregut për këtë tregues në tremujorin e dytë të vitit 2018, pjesa e tregut të postës shqiptare në tremujorin e dytë të vitit 2019 ka arritur në rreth 25%, përkundrajt rreth 75% të ofruesve të tjerë.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 638,516 objekte postare ose 90%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 73,782 objekte postare ose 10%.

Përsa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri paraqitet në vlerën 50,827 objekte postare, shifër kjo dukshëm më e madhe se sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit në vlerë 22,955 objekte.